



## NJËSIA E BURIMEVE NJËRZORE

Nr. 13-111/01-0009796/25

Datë 12.02.2025

Në bazë të nenit 78, paragrafi 2, nenet 81 dhe 82 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 90/2010), nenit 5, Rregulorja (QRK) nr.27/2024 për procedurat e konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të punës, Komuna e Podujevës shpallë:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lire/Zëvendësim	Numri i pozitave
1.	SHFMU	Punëtor teknik	“Ali Ajeti “-paralelja e ndar në Lladofc	1

#### Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lendeve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;
- Të përkujdeset për rregullimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për rregullimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

#### Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm

#### Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Certifikata e lindjes;
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);

- Dëshmi mbi kualifikimin;
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatet të cilët pranohen pas publikimit të rezultateve).

### **Afati dhe mënyra e aplikimit**

**Data e aplikimit:** në web-faqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej datës **13.02.2025** deri më datën **27.02.2025**

Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës-<http://kk.rks-gov.net/podujeve> po ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës.

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

**Vërejtje:** Pas aplikimit kandidatët të ruajnë dëshmit e aplikimit, e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.

Komunitete jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqsim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrarët Publikë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen.

Vlerësimi I kandidatëve bëhet nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit dhe një interviste me gojë.